

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Reagimi - Shtëpia e Bardhë hedh poshtë raportin e OKB-së që pretendon se SHBA-ja ka kryer krime luft e në Iran
ADRESA	https://www.syri.net/bote/917604/shtepia-e-bardhe-hedh-poshte-raportin-e-okb-se-qe-prete-ndon-se-shba-ja-ka-kryer-krime-lufte-ne-iran/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 13:45:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 13:17:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cc118f8c5649db642eab072700dbb07485afe3d9ffbeeead8b7c12bc369d600c
TEKSTI	99928d480111400925865f5f70c4847fc1f923e09108ce10f465d542e482f876
PAMJA	058ce4b4c05d6f593b541d1764f15f908e76d67502b6bf8a27af284965684ca2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	858230e5c10518c745c858bda14a2b7e637a252a693d4efd8e95d85d0fbe3a35
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9c628a07075feceb8104ab280f983adfb76a5f01a86c5eb5ef058772798de17b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/858230e5c10518c745c858bda14a2b7e637a252a693d4efd8e95d85d0fbe3a35>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**PROF. MYQEREM TAJAJ**

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!

**SONILA MEÇO**

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi

**më të lexuarat**

Pakistani dënon përpjekjen 'e neveritshme' për sulm me dron pranë Mekës

Forcat izraelite tërhiqen nga qyteti perëndimor i Sirisë pas një ofensive disa orëshe

Ushtria izraelite nis sulme të reja në Libanin jugor pavarësisht marrëveshjes kornizë

Konferenca e IAEA-s/ Irani note proteste Austrisë pasi shefit bërthamor iu mohua hyrja në Vjenë

Filipine/ 6 nxënës të vrarë dhe 17 të tjerë të plagosur nga të shtënat në një shkollë të mesme

Sanksionet e SHBA ndaj Rusisë/ Kina kundër: Marrëdhëniet dypalëshe s' duhet të prishen



Shtëpia e Bardhë hedh poshtë raportin e OKB-së që pretendon se SHBA-ja ka kryer krime lufte në Iran

15:17, 18/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Shtëpia e Bardhë ka hedhur poshtë një raport të një misioni të pavarur faktmbledhës të Kombet e Bashkuara, i cili tha se ka dyshime të arsyeshme për të besuar se Shtetet e Bashkuara kanë kryer krime lufte gjatë dy sulmeve ajrore në Iran.

Misioni i Pavarur Ndërkombëtar Faktmbledhës për Iranin tha në një raport të publikuar më 17 shtator se ka dyshime të arsyeshme për të besuar se forcat amerikane kishin kryer krim lufte gjatë sulmeve ndaj një shkolle në Minab dhe ndaj një objekti sportiv në Lamerd më 28 shkurt.

Sipas misionit, në dy sulmet u vranë të paktën 178 civilë, përfshirë gra dhe fëmijë. Sulmi në Minab goditi Shkollën Fillore Shajareh Tayyebhe dhe vrau më shumë se 150 persona, përfshirë rreth 120 nxënës.

Një sulm i ndarë ndaj një kompleksi sportiv dhe zonës së banuar përreth në Lamerd vrau 22 civilë.

Në një përgjigje të ashpër me shkrim ndaj raportit, zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Anna Kelly, i hodhi poshtë gjetjet.

"E vetmja palë në këtë konflikt që ka kryer krime lufte është regjimi iranian, i cili ka vrarë mijëra njerëz të vet, ka vrarë amerikanë jashtë vendit, ka kryer akte terrorizmi në Ngushticën e Hormuzit dhe ka kryer sulme pa dallim ndaj fqinjëve të tij në rajon", tha ajo.

Kelly tha po ashtu se Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut "nuk ka bërë asgjë për të drejtat e njeriut, teksa për dekada ka thënë broçkulla joserioze".

Zyrtarët amerikanë kanë thënë vazhdimisht se operacionet ushtarake kryhen në përputhje me ligjin për konflikt të armatosur dhe se po zhvillohet një hetim.

SHBA-ja dhe Izraeli nisën sulmet ajrore ndaj Republikës Islamike në fund të shkurtit dhe Irani u kundërpërgjigj duke kryer sulme në mbarë rajonin e Lindjes së Mesme.

Raporti pritet t'i prezantohet zyrtarisht Këshillit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, që ka 47 anëtarë, në Gjenevë më 21 shtator.

Misioni po ashtu tha se ka dyshime të arsyeshme për të besuar se autoritetet iraniane kryen krime kundër njerëzimit gjatë shtypjes së protestave mbarëkombëtare në dhjetor 2025 dhe janar 2026. Ai përmendi vrasje të paligjshme, ndalime arbitrare, torturë dhe akte të tjera çnjerëzore të kryera si pjesë e një sulmi të gjerë dhe sistematik ndaj civilëve. /REL/

© SYRI.net

Lexo edhe:



Lufta kundër trafikantëve të drogës, Belgjika zgjat me 6 muaj vendosjen e ushtarisë në rrugët e Brukselit



MI5 pranon se dha prova të bazuara në gënjeshtër në rastin e spiunazhit neonazist



Alarmi për dronë pezullon zgjedhjet parlamentare në Soçi të Rusisë

Rusia dhe Ukraina shkëmbejnë sulme gjatë natës, dëme në të dyja palët

BE i hap derën Kanadasë për t'u bërë 'anëtarja e parë e asociuar' e bllokut

Trump kërcënon BE me ndërprerje të tregtisë nëse Kanadaja bëhet anëtare e asociuar

TË NGJASHME



'Viktima më e re, një 4-vjeçare' - OKB dokumenton dhunën seksuale dhe torturat e forcave ruse në Ukrainë



Sulmet në bazën ajrore në Arabinë Saudite, goditet avioni italian F-2000



Austria prezanton ligjin e ri - Qeveria synon neutralitetin klimatik deri më 2040



Të paktën 15 të vdekur e 50 të plagosur nga shpërthimi i një makine-bombë në Pakistan



Të paktën 14 të vrarë në një sulm me makinë-bombë në Pakistan



Tensione gjatë zhvendosjes së emigrantëve në Ceuta



Kandidatja e BE-së, Moldavia, në kërkim të kohës së humbur

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.